Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEËE BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Zenel Hisenaj	*Data e autorizimit të ekspertit* *21.05.2021*	*Data e dorëzimit të raportit* *30.05.2022*	Nr. i lëndës: 137 /22

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 11.05.2022, **TECH VISION SH.P.K. & Mehmet Sahitolli B.I. dhe Nita Macula B.I." -,** Prishtine ka parashtruar ankesë me nr: 137/22, kundër anulimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Furnizim me pajisje te IT-së**" me nr. të prokurimit: **632-21-10162-5-5-8**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KK Gjakovë**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, , lloji i kontratës: Furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: **48.890,00** €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE ---" TECH VISION SH.P.K. & Mehmet Sahitolli B.I. dhe Nita Macula B.I."

Në vazhdim "TECH VISION" shpk nga Prishtina, Ju prezanton Pikat e ankesës, për shkeljet e bëra nga ana e Autoritetit Kontraktues- Komuna e Gjakovës, i cili ka bërë shkelje flagrante të LPP'së, fillimisht në momentin e publikmit të njoftimit për anulimi e dhënies së kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me pajisje te IT-së", e pataj me kualifikimin e kërkesës për rishqyrtim, të dorëzuar nga ana jonë si të pabazuar, me preteksin se kompania Tech Vision sh.p.k & Mehmet Sahitolli B.I dhe Nita Macula B.I, më datën 22.02.2022, nga AK-Komuna e Gjakovë përmes platformës elektronike ka pranuar kërkesën për vazhdim të validitetit të ofertës, dhe se kinse ne nuk e kemi bërë vazhdimin e validitetit të ofertës.

Fillimisht ne zotohemi me përgjegjësi të plotë morale dhe njerëzore se asnjëher nuk e kemi pranuar një kërkesë të tillë nga AK, dhe se ky dokument nuk ekziston në account'in tonë në platformën elektronike "e-prokurim", as tek dokumentet e pranuar nga AK, dhe as tek detajet mbi aktivitetin e prokurimit, aty ku ne pranojmë çdo informat në lidhje me aktivitetet e prokurimit në të cilat kemi qenë pjesë, ose janë aktivitete të "preferuara", nga ana jonë.

Tek të dy këto dy opcione të cilat i jep platforma e-prokurimit ne i kemi listuar dhe kemi prezantuar pamjet të asaj se çfarë paraqitet tek ne në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit.
Autoriteti Kontraktues në vendimin e datës 29.04.2022, mbi refuzimin e kërkesës për rishqyritm përveq refuzimit të kërkesesë si të pabazuar ka deklaruar se do të vazhdojë me dhënien e kontratës të Operatorit Eknomik me radhë.

Po të ekzistonte vërtet vullneti i Autoritetit Kontraktues- Komuna e Gjakovës për zbatimin e Ligjit për Prokurim Publik, si dhe legjislacionit në fuqi në vendin tonë, Autoriteti Kontraktues ka pasur mundësi fare lehtë që të verifikojë nëse ne kemi pranuar Kërkesën për zgjatje të validitetit të ofertave apo jo, kur ne disa herë ju kemi drejtuar me email AK'së, për tu interesuar se çfarë ka ndodhur me këtë procedurë, ngase ne me kërkesën e AK'së, tashmë kishim dërguar fizikisht dokumentet e përshtatshmërisë (Vërtetimin nga Gjykata dhe ATK për GOE), si dhe po të njëjtat i kemi ngritur në sistemin elektronik të prokurimit.

Një fakt tjetër mjaftë interesant është se si ka mundësi që ne nga AK (siç shihet dhe në foton të cilën e kemi bashkangjitur si provë), kemi pranuar ftesën për ofertim dhe Letren Standarde e kerkesese per sqarimin e tenderit, por nuk kemi pranuar kërkesën të cilën Autoriteti KontraktuesKomuna e Gjakovës pretendon se na ka dërguar.

Me qëllim të zbardhjes së vërtetës ne kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, të konfirmojë nëse Autoriteti Kontraktues- Komuna e Gjakovës, ka dërgur tek ne ndonjëher një kërkesë të tillë për këtë aktivitet të prokurimit apo jo.

❑ Autoritetit Kontraktues, ka shkelur Nenin 1 të LPP-së (Qëllimi), sepse Autoriteti Kontraktues në shpëputhje të plotë me të gjitha diposizitat ligjore të LPP'së, Rregullat dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, Qëllimin e paraparë në këtë aktivitet të prokurimit, si është paraparë ne nenin 1 të LPP, Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

➢ Ne mendojmë se me këtë rast është shkelur Neni 6 i LPP-së, (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti), të njoftimit për anulimi e dhënies së kontratës gjatë vlerësimit të tenderit "Furnizim me pajisje te IT-së ", me preteksin se kompania Tech Vision sh.p.k & Mehmet Sahitolli B.I dhe Nita Macula B.I, nuk e ka bërë vazhdimin e validitetit të ofertës, dhe se Autoriteti Kontratues do të vazhdojë me dhënjen e kontratës të Operatorit Eknomik me radhë.

❑ Qëllimin e paraparë në këtë aktivitet të prokurimit, si është paraparë ne nenin 6 të LPP –së, citojmë :

" 1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit".
"2. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës". Me këtë rast Autoriteti Kontraktues, nuk ka vepruar ne pajtueshmëri me Nenin 6 të LPPsë, sepse me njfotimin e publikua, ka bërë

shkeleje të rënda ligjore, duke nxjerr një Njoftim mbi anulimin e njoftimit për dhënije të kontratës, në fazën kur kan përfunduar të gjitha aktivitetet në lidhje me procedurën në fjalë, dhe në kohën kur kompania jonë dhe AK-Komuna e Gjakovës tashmë janë në mardhënie kontraktuale me çrast AK në mënyrë të pashmangshme tashmë ka krijuar obligime kontraktuale ndaj nesh.

➢ Për më tepër AK-Komuna e Gjakovës, në njoftimin e publikuar ka thënë se do të shpërblejë me kontratë OE, të radhës i cili ka dorëzuar ofertën, me çmin më të lartë se oferta jonë për 2,434.00€, i cili veprim përveq se na dëmton neve si OE, ndaj të cilëve komuna tashmë ka krijuar obligime kontraktuale, do ti krijoj barrë financiare buxhetit të shtetit në vlerën e lartëcekur, dhe rëndon edhe më shum shkeljet ligjore të cilat tenton ti bëjë Komuna e Gjakovës, përmes publikimit të këtij njoftimi, ku përveç shkeljeve ligjore, do të krijojë ngarkesë financiare për buxhetin e komunës në vlerën e kontratës prej 41,866.00€, ngase ne duke qenë në mardhënie kontraktuale me komunën, komuna e Gjkovës, tenton që të lidhë kontratë me një operatorë tjetër ekonomik, për të njëjtin aktivitet të prokurimit, duke neglizhuar me qëllim të realizimit të kontratë brenda afateve ligjore të parapra në Ftesën për ofertim, kemi qenë të detyruar të realizojmë të gjitha blerjet e paisjeve në bazë të kontratës, duke pasur parasysh se afati për liferimin e paisjeve ka qenë vetm 3 ditë, nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

❑ Autoritetit Kontraktues, ka shkelur nenin 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi për faktin se:

➢ Grupi i operatorëve ekonomik TECH VISION SH.P.K. & Mehmet Sahitolli B.I. dhe Nita Macula B.I., pasiqë me datët 12.04.2022, përmesë platformës elektronike të prokurimit publik, ka paprovuar "DRAFT KONTRATËN", dhe më datën 14.04.2022, ne kemi pranuar një e-mail nga AK,- Komuna e Gjakovë, ku sqarohen dokumentet të cilat duhet ti posedojmë me vete në momentin e paraqitjes për nënshkrim të kontratës, dhe në po të njëjtën ditë kontaktohemi përmes telefonit nga AK, të cilën na informojnë se ne mund të paraqitemi dhe më herët për nënshkim të kontratës, gjithashtu më datën 14.04.2022, në platformën e-prokurim, ka publikuar Njoftimin për dhënie të kontratës.

➢ Publikimi i njoftimi për anulimin e kontratës, pa një vendim paraprak, për neve ka qenë shokuese, ngase pas përfunditmit të të gjitha procedurave të parapara me LPP'në, AKKomuna e Gjakovës, në kohën kur ne po prisnimin ftesën e AK'së për nëshkrim të kontratë, për habi AK publikon NJOFTIMIN MBI ANULIMIN E DHËNIES SË KONTRATËS, duke përdorur një metod diskriminuese ndaj kompanisë tonë.
Neni 108/A -Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve- paragrafi 10.2 i LPP'së 10.2. të miratojë një kërkesë për rishikim si të bazuar dhe të anulojë pjesërisht ose tërësisht vendimin e miratuar.

➢ Autoriteti Kontraktues -Komuna e Gjakovës, në kundërshim të plotë me Nenin 108/A, paragrafi 10.2, ka bërë anulimin e njoftimit për dhënies të kontratës, pa një vendim paraprak, dhe pas publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës, dhe pas aprovimit të draft kontratës, për faktin se mes nesh dhe Autoriteti Kontratues nuk ka pasur ndonjë mosëmarrëveshje eventuale të krijuar, përkundur kësaj ne kemi pasur një komunikim zyrtar mjaft të mirë me AK'në, dhe në të gjitha kërkesat për informata shtesë të cilat i ka kërkuara AK, nga ne si OE , jemi përgjigjur brenda afateve kohore të përaktuara nga AK, për zgjidhjen e të cilës AK, ka kërkuar zgjidhje miqësore, dhe mbi bazën e të cilës është thirrur AK, në momentin e publikimit të njoftimit për anulimin e njoftimit për dhënie të kontratës.

Neni 31.3 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (RRUOPP), përcakton:

"31.3 Periudha e validitetit të tenderit e specifikuar në dosjen e tenderit do të ndryshoj varësisht nga kompleksiteti i prokurimit. Periudha e kërkuar e validitetit do të jetë jo më shumë se që është e nevojshme, dhe do të jetë e mjaftueshme për AK të bëjë vlerësimin e tenderëve të pranuar dhe të bëjë dhënien dhe nënshkrimin e kontratës".
Neni 31.4 i RRUOPP, përcakton: Neni 31.4 i RRUOPP Nën situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar që procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit të tenderëve për arsye të detajeve komplekse teknike të sqaruara, AK do të kërkoj nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. Kërkesa për zgjatje të validitetit të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohet para datës së skadimit (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit)"

Neni 31.5 i RRUOPP - Në përputhje me rrethanat, nga të gjithë tenderët do të kërkohet që gjithashtu të zgjasin validitetin e sigurimit të tenderit të tyre.

Sipas nenit 31.4 të lartcekur, nuk përcaktohet sa ditë para skadimit të validitetit të ofertave mund të kërkohet zgjatja e afatit të validitetit të ofertave. Megjithatë, është e rëndësishme që të ketë kontinuitet midis afatit të skaduar dhe atij të ri, për këtë arsye në këtë dispozitë thuhet: "para datës së skadimit...."

Neni 31.3 i RRUOPP- kërkon rreptësishtë që oferta të ketë validitet deri te dhënia dhe nënshkrimi i kontratës. Prandaj KRPP konsideron se asnjë kontratë publike nuk mund të nënshkruhet me validitet të skaduar të ofertës.

Për këtë arsye, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit duhet me kujdesin më të madh të përcjellë validitetin e ofertave, dhe në çdo rast duhet të kërkojë nga të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës zgjatjen e validitetit të ofertave para datës së skadimit. Në mënyrë retroaktive nuk mund të kërkohet zgjatja e validitetit të ofertave dhe/ose e sigurisë së tenderit.

➢ Në bazë të dispozitave ligjore të lartëcekura shihet mjaftë qartë se validiteti i ofertave, është përgjegjësi e autoritetit kontratues, gjegjësisht është përgjegjësi e Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, dhe përpjekja e AK'së të na fajsojë neve e aq më pak të na penalizojë se kinse ne nuk e kemi bërë zgjatjen e validetit të ofertave, përderisa ne nuk kemi pranuar as edhe një kërkesë të vetme nga AK, dhe një përpjekje e tillë përveqse është plotësishtë jo ligjore, është edhe jo njerzore, për më tepër tentimi që përmes një lëshimi të bërë nga vet AK, të dëntohet financiarisht në vlerën prej 41,866.00€ , për ne është plotësisht e papranueshme, dhe në rast të mos aprovimit të kërkesën tonë për rishqyri, ne do të mbetemi të detyruar ti ndjekim të gjitha rrugët ligjore, në bazë të legjislacionit në fuqi në vendin tonë, në mënyrë që të mos lejojmë ti shkaktohet një dëm i tillë kompanisë tonë, ngase do të ishte një ngarkesë dhe goditje me pasoja të mëdha në vazhdimin e funksiomit për ne si biznes.

➢ Kurse pretendimet e Autoriteti Kontraktues-Komuna e Gjakovës, se më datë 22.02.222, ka dërguar kërkesën për zgjatjen e validitetit, janë plotesisht të paqëndrueshme, ngase ne asnjëhere nuk e kemi pranuar një kërkesë të till nga AK, as në platformën elektronike (ashtu siç pretendon AK), dhe as përmes e-mailit.

➢ Për informimin tuaj, ne ju kemi drejtuar dy herë AK'së me kërkesën për informim rreth rreth zhvillimeve të këtij aktiviteti të prokurimit, meqënese tashmë me kërkesë të autoritetit kontraktues kishim derguar në formë fizike dhe elektronike vërtetimet e gjykatës dhe ATK'së, dhe është për tu habitur fakti se si AK, nuk ka kthyer përgjigje në emailin e dytë përmes të cilës dhe edhe një kemi kërkuar sqarim nga AK në lidhje me këtë aktivitet, e për ironi emaili i dytë rezulton të jetë pikërisht më 23.02.2022, që i bile të jetë vetë një ditë pas kërkesë së supozuar për zgjatje të validitetit, të cilën AK pretendon se na ka dërguar. Provë: Emailat e dërguar tek AK me datë 19.01.2022, dhe 23.02.2022.

Lidhur me Ftesën: Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative

ME Me <techvision@techvision-ks.com>

Wed, 19 Jan 2022 2:52:59 PM +0100 SENT

To "fatongutaj" <faton.gutaj@rks-gov.net>

Tags

Pershendetje i/e nderuar;

Deshtëm të ju pyesim lidhur me Ftesën në mini-tender me titull: **Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative** dhe me numër të prokurimit: **632-21-10162-5-5-8.** Ne si kompani në këtë aktivitet të prokurimit jemi oferta më e lire, duke pasur parasysh që afati i liferimit është 3 ditë nga lëshimi i urdhërblerjes neve na duhet të dimë se kur mendoni ta realizoni këtë kontratë pasi që disa nga produktet i kemi në stok, dhe rrjedhimisht nëse ky stok shitet, në porositë e reja ndryshojnë çmimet.

Faleminderit për mirëkuptim!
Gjitha të mirat.

Re: Lidhur me Ftesën: Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative

ME Me <techvision@techvision-ks.com>

Wed, 23 Feb 2022 10:38:24 AM +0100 SENT

To "fatongutaj" <faton.gutaj@rks-gov.net>

Tags

Pershendetje i nderuar,

Po ju shkrujam prap lidhur me aktivitetin e prokurimit /mini-tender me titull: **Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative** dhe me numër të prokurimit: **632-21-10162-5-5-8**, per te cilin me date 02.02.2022 ne baze te kerkese tuaj te date 26.01.2022 ne i kemi sjellur verteimin nga **Gjykata** dhe **ATK** fizikisht dhe na eshte thene qe me se largu dy jave do te fillojme me proceduarat e nevojshme (Vendimi e Autoriteti Kontraktue) per kaluar ne fazen kontraktuale, e nga ajo kohe kan kalur me shume se tre jave dhe ne ende nuk kemi ndonje njoftim lidhur me kete qeshtje, ju lutem qe te na informoni se kur palnifikoni te realizoni kete kete kontrate pasi dihet qe vlera e saj nuk eshte e vogel dhe disa nga paisjet i kemi ne stok dhe paraqt problem te mbahen ne stok per nje kohe te gjate. Edhe nje here kerkojm nga ju te na njoftoni me afate e fillimi te fazes kontraktuale pasi ky informacion eshte i nevojshme per palinifikimet e liferimve.

Presim pergjigjje tuja,

Gjitha te mirat,

Interesimi jonë rreth këtij aktiviteti të prokurimit tregon se ne gjithëmon kemi qenë të interesuar të pëmbyllim me sukses këtë aktivitet të prokurimit.

➢ Përkundrazi ne kishim pranuar njoftimin mbi vednimin e AK'së në bazë të së cilit ne ishim shpërbyler me kontratë, dhe meqnëse afati i liferimit i paraparë në FO, ku mbi këtë kërkesë oblgative ne në momentin e dorëzimit të ofertës tonë, kemi dorëzuar dhe deklaratën mbi afatin e liferimit të paisjeve e cila ka qenë vetëm 3 ditë, ne disa herë radhazi ju kemi drejtuar me email Autoriteti Kontraktues, me qëllim të informimit rreth procedurës, duke pasur parasysh mosstabilitetin e tregut të paisjeve të IT'së, të krijuar nga pandemia Covid'19 pasojë kjo e cilat vazhdon të ketë efektin e saj tek prodhuesit, por ne as edhe një herë të vetme nuk kemi pranuar ndonjë përgjigje nga Autoriteti Kontraktues në pyetjet tona të dretjuara me email. Mbështetur në argumentet e cekura më lartë, kërkojmë nga ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT të aprovoj ANKESËN,e parashtruan nga ana jonë, dhe të marr vendim mbi anulimin e Njoftimi për anulimin e dhënies së Kontratës dhe aktiviteti i prokurimi për tenderin "Furnizim me pajisje te IT-së", të vazhohet hapi i fundit në këtë aktivitet të prokurimit pra procedura e nënshkrimit të kontratës.

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë te njëjta.

KRITERET PËR VLERËSIM

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "TECH VISION SH.P.K. & Mehmet Sahitolli B.I. dhe Nita Macula B.I.

Përgjigje ne pretendimin Ankimor 1.

Bazuar ne rrjedhën e këtij Aktiviteti te prokurimit, rezulton se OE ka plotësuar te gjitha kriteret e parapara për këtë Aktivitet te prokurimit, me çka edhe AK ka ftuar te njëjtit për nënshkrim te kontratës gjë qe rezulton se i njëjti plotëson te gjitha kriteret për këtë aktivitet te prokurimit.

Ne këtë Rast AK është përgjegjës per kërkesën e vazhdimit te validitetit te ofertës, gjë ne këtë rast sipas dokumenteve përkatëse nuk është kërkuar asnjë here një veprim i tille prej OE-së, me çka barra përgjegjësisë për këtë veprim bie mbi AK-ne.

Rezultuar pyetjeve te Shpeshta, KRPP- ka lëshuar këtë Interpretim:

69. 06.02.2020. Periudha e validitetit të ofertës ka skaduar derisa lënda ka qenë në shqyrtim në OSHP dhe aktiviteti i prokurimit ka qenë në pezullim. A mund të nënshkruhet një kontratë publike pa validitet të ofertës?

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, KRPP ofron interpretimin ligjor si në vijim:

Neni 31.3 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (RRUOPP), përcakton:

"31.3 Periudha e validitetit të tenderit e specifikuar në dosjen e tenderit do të ndryshoj varësisht nga kompleksiteti i prokurimit. Periudha e kërkuar e validitetit do të jetë jo më shumë se që është e nevojshme, dhe do të jetë e mjaftueshme për AK të bëjë vlerësimin e tenderëve të pranuar dhe të bëjë dhënien dhe nënshkrimin e kontratës".

Neni 31.4 i RRUOPP, përcakton:

"31.4 Nën situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar që procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit të tenderëve për arsye të detajeve komplekse teknike të sqaruara, AK do të kërkoj nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. Kërkesa për zgjatje të validitetit të tenderit do të bëhet me shkrim dhe ***duhet të kërkohet para datës së skadimit*** *(është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit)"*

31.5 Në përputhje me rrethanat, nga të gjithë tenderët do të kërkohet ***që gjithashtu*** *të zgjasin validitetin e sigurimit të tenderit të tyre.*

Sipas nenit 31.4 të lartcekur, nuk përcaktohet sa ditë para skadimit të validitetit të ofertave mund të kërkohet zgjatja e afatit të validitetit të ofertave. Megjithatë, është e rëndësishme që të ketë kontinuitet midis afatit të skaduar dhe atij të ri, për këtë arsye në këtë dispozitë thuhet: ***"para datës së skadimit...."***

Pavarësisht se aktiviteti i prokurimit është në "Pezullim", AK në përputhje me nenin 31.4 të RRUOPP **duhet që të kërkojë zgjatjen e validitetit të ofertave para datës së skadimit.**

Asnjë dispozitë e LPP-së dhe e legjislacionit dytësor nuk përcakton përkufizimin e fjalës "Pezullim", megjithatë KRPP konsideron se fjala "Pezullim" në kuptim të këtij ligji duhet të nënkuptojë mosndërmarrjen e ndonjë hapi në procedurat e prokurimit për derisa aktiviteti i prokurimit është i pezulluar. *(Psh:* ***hapja e tenderëve*** *nuk duhet të bëhet nëse aktiviteti i prokurimit është pezulluar si rezultat i Kërkesës për rishqyrtim e parashtruar në AK, apo e një ankese e parashtruar në OSHP gjatë fazës së tenderimit, apo* ***nënshkrimi i kontratës*** *nuk duhet të bëhet për deri sa aktiviteti i prokurimit është në pezullim si rezultat i parashtrimit të një kërkese për rishqyrtim në AK, apo një ankese në OSHP)*

Neni 31.3 i RRUOPP kërkon rreptësishtë që **oferta të ketë validitet deri te dhënia dhe nënshkrimi i kontratës**. Prandaj KRPP konsideron se asnjë kontratë publike nuk mund të nënshkruhet me validitet të skaduar të ofertës.

Për këtë arsye, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit duhet me kujdesin më të madh të përcjellë validitetin e ofertave, dhe në çdo rast duhet të kërkojë nga të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës zgjatjen e validitetit të ofertave para datës së skadimit**. Në mënyrë retroaktive nuk mund të kërkohet zgjatja e validitetit të ofertave dhe/ose e sigurisë së tenderit.**

KRPP do të monitorojë me kujdesin e veçantë autoritetet kontraktuese për moszbatimin e nenit 31.4 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik dhe do të shqiptojë "**Vërejtje me shkrim"** në përputhje me Nenin 5, paragrafin 7 të Rregullores Nr. 2/2017 për Procedurat e Dhënies dhe Revokimit të Certifikatës Profesionale për Prokurimin Publik.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, dhe ky aktivitet i prokurimit te Anulohet për arsye te gabimeve te AK-se.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – Komuna Gjakovë
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues – TECH VISION SH.P.K. & Mehmet Sahitolli B.I. dhe Nita Macula B.I.